Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Klasa jonë po bëhet gati për të nisur një vit interesant të *Matematikës së Ndikimit*. Disa nga temat që do të studiojmë janë: numrat negativë, eksponentët, gjeometria tripërmasore, përpjesëtimet, probabiliteti dhe analiza e të dhënave. Gjatë vitit, nxënësit gjithashtu do të zhvillojnë dhe përsosin aftësitë në algjebër.

Do të fillojmë me shqyrtimin e shprehjeve algjebrike – kombinimet e numrave, shkronjave dhe simboleve matematike, që përfaqësojnë gjuhën e algjebrës. Do të njihemi me ndryshoret – shkronja ose simbole që mund të ndryshojnë në vlerë, ose të përfaqësojnë madhësi të panjohura. Për shembull, në shprehjen $b + 2$, ndryshorja është b.

Pasi të jemi familjarizuar me ndryshoret dhe shprehjet, do të krijojmë diagrama që u përgjigjen shprehjeve dhe do t'i përdorim ato diagrame për të zgjidhur ekuacione. Gjithashtu do të analizojmë formula që përdoren në jetën e përditshme, si për shembull formula e konvertimit të gradëve Celsius në gradë Farenhait: $F = \frac{9}{5} \times C + 32$.

Fjalor Gjatë këtij kapitulli do të mësojmë një varg termash të rinj:

shprehje algjebrike	**eksponent**
mënyrë prapakthyese	**faktor**
veti shpërndarëse	**diagram**
shprehje të barasvlershme	**formulë**
zgjeroj	**ndryshore**

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Inkurajojeni nxënësin që t'ju shpjegojë se çfarë problemesh është duke zgjidhur në klasë. Veç kësaj, nxiteni të mendohet për shembuj të zakonshëm të përdorimit të shprehjeve algjebrike në jetën e përditshme. Interesimi juaj në punën e fëmijës e ndihmon këtë të kuptojë më mirë rëndësinë dhe dobinë e matematikës në jetën e përditshme.